



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.34, datë 18.03.2024

PËR

“PEZULLIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
MAGJISTRATES, ZONJËS PRANVERA STAFA SELITA”

Bazuar në nenin 149, pika 1 dhe nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 184, germa “dh” dhe nenin 189, pika 1, germa “a” dhe pika 3, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional ndaj magjstrates Pranvera Stafa Selita, me arsyetimin sipas Relacionit shoqërues të këtij vendimi.
2. Ky pezullim ka efekt deri në administrimin e vendimit përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar ndaj prokurores Pranvera Stafa Selita, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit kalimtar.
3. Ky vendim i njoftohet prokurores Pranvera Stafa Selita, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 18.03.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj